

---

# Përkrahje Integritetit të Informatave dhe Diskursit Politik Civil



2018

---



# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>Përmbledhje .....</b>  | <b>3</b>  |
| <b>Përkufizimet .....</b>   | <b>3</b>  |
| <b>Kërcënim çdo herë e më i madh për demokracinë .....</b>            | <b>4</b>  |
| <b>Sqarim i përkufizimeve të shpeshta .....</b>                       | <b>5</b>  |
| <b>Llojet më të shpeshta të keqinformimit dhe dezinformimit .....</b> | <b>6</b>  |
| Misinformation .....  | 6         |
| Disinformation .....  | 7         |
| <b>Kryerësit e veprave të tilla dhe motivet e tyre .....</b>          | <b>7</b>  |
| <b>Shpërndarja e informatave.....</b>                                 | <b>7</b>  |
| <b>Instrumentet e shpeshta të dezinformimit .....</b>                 | <b>8</b>  |
| <b>Kundërmasat për luftimin e dezinformimit .....</b>                 | <b>9</b>  |
| <b>Faktorët që ndikojnë në përhapjen e dezinformatave.....</b>        | <b>10</b> |
| <b>Country Examples.....</b>  | <b>10</b> |
| France .....  | 10        |
| Kenya.....  | 11        |
| Mexico .....  | 11        |
| Myanmar.....  | 11        |
| Nigeria.....  | 12        |
| Serbia .....  | 12        |
| Syria .....   | 12        |
| Ukraine.....  | 13        |
| United Kingdom.....   | 13        |
| <b>Shembuj të vendeve të ndryshme .....</b>                           | <b>14</b> |
| <b>Mirënjohjet .....</b>  | <b>15</b> |



# Përmbledhje

Qëllimi i këtij resursi është që të ngrisë vetëdije mbi rrezikun nga dezinformimi dhe mënyrat se si ai shfrytëzohet për të penguar funksionimin e institucioneve dhe proceseve demokratike. Ky resurs ka për qëllim t'u ndihmojë aktivistëve nga shoqëria civile dhe politika në mbrojtjen e parimeve të dialogut të bazuar në informata dhe shqyrtimit publik të politikave. I njëjti mbulon edhe sigurimin e rrjedhës së informatave të sakta dhe përkrahjen e praktikave të një diskursi politik të qytetëruar.

## Terms

### Dezinformata

Informata e rrejshme apo e pasaktë e cila krijohet apo shpërndahet me dashje, me qëllim që të shkaktojë dëm apo udhëzojë gabimisht pranuesin.

### Keqinformimi

Informata e rrejshme apo e pasaktë, e cila nuk ka për qëllim shkaktimin e dëmit.

### Informimi qëllimkeq

Informata e saktë e cila shpërndahet me qëllim të shkaktimin të dëmit, shpesh duke bartur në domenin publik informatat që kanë për qëllim të mbesin private, siç është publikimi i informatave personale apo private (eng. Doxing).

### Algoritmi

Një sërë hapash që i ndërmerr një kompjuter për të zgjidhur një problem apo kryer një detyrë. Për shembull, platformat e mediave sociale shfrytëzojnë algoritmet për të përpiluar përmbajtjen që iu paraqitet përdoruesve. Këto algoritme dizajnohen veçanërisht për t'u shfaqur përdoruesve materiale për të cilat ata kanë interes, bazuar në historinë e përdoruesit dhe interesat që ata kanë shfaqur në platformën në fjalë në të kaluarën.

### Automatizimi

Procesi i delegimit të kryerjes së një detyre tek një 'makinë', pa ndërhyrje apo me fare pak ndërhyrje njerëzore. Përmes këtij procesi, detyrat për kryerjen e së cilave njerëzve do tu duhej shumë kohë kryhen me shpejtësi dhe pothuajse pa kurrfarë mudi.

### Botët

Llogari në media sociale të cilat operohen tërësisht nga programe kompjuterike dhe kanë për qëllim gjenerimin e postimeve dhe/ose kycjen në përmbajtje të caktuar në platforma të caktuara.

### Botnet

Grup apo rrjet i botëve që veprojnë në mënyrë të koordinuar dhe zakonisht operohen nga një person apo grup.

### Deep Fake

Përshkruan formatet mediatike të fabrikuara që sajohen duke shfrytëzuar inteligjencë artificiale (IA). Duke krijuar sintezë të elementeve të ndryshme të fajllave ekzistues të formatit video apo audio, IA përmes metodave relativisht të lehta krijon përmbajtje 'të re', në të cilën individë të caktuar duket se flasin apo kryejnë veprime, por e cila nuk është reale.

### Kontrollimi i fakteve

Procesi i verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së informatave zyrtare të publikuara si deklaratatë të politikanëve dhe lajme.

### Amplifikimi i fabrikuar

Ndodh kur shpërndarja apo shtrirja e informatave nxitet me mjete artificiale.

### Propaganda

Informata të sakta apo të rrejshme që shpërndahen për ta bindur një audiencë të caktuar, por shpesh kanë konotacione politike dhe janë të lidhura me informata të sajua nga qeveritë.

### Trolling

Akt i postimit të qëllimshëm të përmbajtjes ofenduese apo nxitëse në një komunitet online, me qëllim të provokimit të lexuesve apo pengimit të një konverzacioni. Termi 'troll' shfrytëzohet kryesisht për t'u

referuar një personi që bezdisë apo fyen të tjerët.

### **Fermë Trollësh**

Grup individësh që veprojnë si trollë apo veprojnë si botë duke promovuar çështje të caktuara në mënyrë të koordinuar.

## **Kërcënim çdo herë e më i madh për demokracinë**

Informatat janë burim i pushtetit dhe sistemet demokratike kanë potencial për të shpërndarë këtë pushtet. Në këtë kuptim, informatat përbëjnë mjet çlirimi kur qytetarët mund t'iu qasen atyre, t'i pranojnë ato dhe t'i krahasojnë gjatë ushtrimit të lirive themelore të të folurit, grumbullimit dhe asocimit. Demokracia gjithashtu bazohet në angazhim aktiv të qytetarëve në jetën publike. Ajo ndërthen pjesëmarrjen në procese politike, siç janë zgjedhjet e rregullta konkurruese me të cilat vendoset për përbërjen e qeverisë. Pjesëmarrja në to varet nga besimi në institucione që punojnë në interes publik. Kjo marrëdhënie paraqet një kontratë shoqërore mes qytetarëve dhe shtetit e cila pjesërisht varet nga rrjedha e informatave të sakta që u mundësojnë qytetarëve të kuptojnë se çka qeveria bën dhe për të ndërmarrë vendimet për mënyrat e ndryshme të veprimit përmes së cilave kërkojnë llogari nga qeveria.

Integriteti i informatave është i rëndësishëm jetike për një demokraci të shëndetshme. Kur informatat janë të pasakta apo të rrejshme, ato mund të ndikojnë negativisht në diskutimet e qytetarëve apo në vendimet politike të tyre, duke rezultuar kështu me prishje të diskursit civil dhe komprometim të qëndrimeve të tyre. Aftësia e qytetarëve për të diskutuar idetë lidhur me politikën dhe çështjet publike në një mënyrë të informuar dhe të respektueshme është kyçe për mbrojtjen afatgjatë të demokracisë dhe ndërthen në vete dialogun dhe diskutimet që ndodhin brenda qeverisë dhe mes politikanëve. Ngjashëm me këtë, puna e qeverisë duhet të kuptohet nga qytetarët dhe informatat duhet t'u vihen atyre në dispozicion në mënyrë që ata të mund të kërkojnë llogari nga qeveria për vendimet që i marrin.

Demokracia është në rrezik kur informata të rrejshme apo të pasakta propagohen dhe shfrytëzohen qëllimisht për të zbehur besimin e publikut, polarizuar më tej shoqërinë, përjashtuar zëra të caktuar dhe kufizuar aftësinë e qytetarëve për të vepruar individualisht apo kolektivisht. Dezinformimi mund të jetë edhe më akut gjatë zgjedhjeve, kur ndasitë paraekzistuese mbi prioritetet dhe politikat janë edhe më të theksuara. Gjatë këtyre periudhave, dezinformatat mund të shtyjnë votuesit në një anë apo tjetrën, mund ta pengojnë funksionimin normal të procesit zgjedhor dhe ta përkeqësojnë frustrimin publik. Megjithatë, jo të gjitha përpjekjet për dezinformim lidhen me një eveniment të caktuar, siç janë zgjedhjet. Dezinformimi mund të shfrytëzohet edhe për të ndryshuar hapësirën në të cilën njerëzit diskutojnë çështje, formësojnë besime dhe marrin vendime politike. Dezinformatat nganjëherë shfrytëzohen për të promovuar një narracion më të gjerë me kalimin e kohës apo për të degraduar diskursin publik duke promovuar ndasitë apo cinizmin.

Akterët autoritarë shpesh ndërmarrin hapa të ndryshëm për të ndikuar mbi rrjedhën e informatave. Të tillë janë pengimi i qasjes mbi burime të pavarura të informatave dhe debate publike; kontrollimi i shtëpive mediatike dhe përmbajtjes së informatave që ato e ofrojnë; apo shpërndarja e qëllimshme e dezinformatave të rrejshme për ta keqinformuar publikun. Këta akterë gjejnë vlerë të theksuar në çfarëdo veprimi që degradon besimin e publikut dhe pengon pjesëmarrjen politike të të deleguarve demokratikë të tyre.

Teknologjia e ka ndryshuar në thelb mënyrën e sajimit dhe konsumit të informatave në forma të ndryshme.<sup>1</sup> Me shtrirjen më të gjerë dhe rritjen e qasshmërisë së internetit, duke u bërë më i shpejtë dhe më i lirë, miliarda njerëz kanë mundësi të këmbimit të informatave me njëri-tjetrin më lehtë se

kurdoherë më parë. Ky ndryshim teknologjik përfshin rritjen e mediave sociale, gjë që ka bërë konsumin e informatave përmes rrjeteve online domen publik e jo privat, që kontrollohet nga disa të mëdha. Shpejtësia e shpërndarjes së informatave gjithashtu është rritur me shtimin e numrit të pajisjeve mobile në përdorim dhe përshtetimin e ciklit të lajmeve. Duke qenë se informatat këmbehen mes palëve të ndryshme më shpejtë dhe në kohë reale, vërtetimi i saktësisë së informatave të këmbeyera në disa raste bëhet më i vështirë. Në raste tjera, vërsimi me informata që ndahen është marramendës dhe bëhet çdo herë e më vështirë që të deshifrohet informata e saktë nga ajo e rrejshme. Moskontestimi i saktësisë së informatave është edhe më evident në mjedise digjitale ku algoritmet e personalizuar ia përshtatin përmbajtjen shijeve dhe preferencave të përdoruesve. Këta faktorë, të cilët e kanë karakterizuar revolucionin digjital, e kanë shtuar cenueshmërinë e publikut nga manipulimi me informata të pasakta.

“Akte të politikë kanë shfrytëzuar dezinformimin në dobi të tyre edhe para disa mijëvjeçarëve. Megjithatë, shpejtësia dhe vëllimi i dezinformimit në hapësirën moderne informative duket se e ka amplifikuar efektivitetin e tij dhe ka bërë që shumë pjesëtarë të publikut të jenë më të nevrkosur, më të frikësuar dhe më të dezorientuar. Kjo, në anën tjetër, bën publikun më të cenueshëm dhe ndjeshëm ndaj manipulimit, gjë që rezulton me një cikël të rënies së besimit publik në resurset objektive të informimit, fenomen të cilin disa analistë e quajnë ‘kalbja e së vërtetës’.”

– [NED Issue Brief: How Disinformation](#)

Digjitalizimi i hapësirës informative komplikohet nga sfidat me të cilat njerëzit përballen në garën që kanë me hapin e ndryshimit teknologjik të shpejtë. Faktorët psikologjikë dhe normat sociokulturore formësojnë mënyrën se si njerëzit i procesojnë informatat, me lloje të ndryshme të informatave që gjenerojnë reagime racionale apo irracionale. Mjediset e mediave digjitale, në veçanti platformave të mediave sociale ku informatat këmbehen me shpejtësi, mund të promovojnë përpunim të menjëhershëm dhe jologjik të informatave dhe jo reagime racionale të cilat bazohen në vlerësime të kujdesshme.<sup>2</sup>

Përderisa manipulimi me informata në demokraci nuk përbën risi, teknologjia digjitale ka ngritur përmasat e këtij problemi duke u mundësuar akterëve keqdashës manipulimin anonim të opinionit publik dhe kërcënimin e integritetit të informatave. Mediat sociale amplifikojnë këtë efekt për shkak të kostos relativisht të ulët dhe shpejtësisë së shpërndarjes së informatave tek audiencat e gjera.<sup>3</sup> Ky fenomen shpesh ndikohet nga sisteme të automatizuara, siç janë botët, të cilët përdoruesve iu dërgojnë përmbajtje të përzgjedhur në bazë të preferencave të tyre personale dhe faktorëve demografikë.

## Sqarim i përkufizimeve të shpeshta

Lajmet e rrejshme (eng. **fake news**) është term që përdoret si zëvendësim për dezinformim dhe lloje tjera çrregullimesh në ekosistemin e informimit dhe është shndërruar në një term më të gjerë që shfrytëzohet për të përshkruar kompleksitetin e dezinformimit, keqinformimit dhe informimit të gabueshëm, dhe shpesh shfrytëzohet nga persona autoritarë dhe të tjerë për të degraduar të vërtetën që nuk u pëlqejnë, duke i zbehur ato me narracione të rrejshme.<sup>4</sup>

**Dezinformimi** është informatë e rrejshme e krijuar qëllimisht për t'i shkaktuar dëm një personi, grupi social, organizate apo shteti. Dezinformata nuk përbëhet gjithmonë nga gënjeshtat. Ajo mund të përbëhet edhe nga fakte të cilat janë ndarë nga konteksti origjinal, fakte që janë të shtrembëruara nga retorika paragjyquese ose diskriminuese apo fakte që janë të ndërthurura me informata të rrejshme.

### Shembull

Kompania e sigurisë kibernetike nga Kalifornia 'FireEye' ka zbuluar një fushatë disavjeçare të dezinformimit që kishte për synim Amerikën Latine, Lindjen e

Mesme, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara.<sup>5</sup> Kompania ka gjetur mbi 600 llogari të mediave sociale me bazë në Iran të cilat kishin për qëllim shpërndarjen e dezinformatave në tërë globin. FireEye ndau këto informata me Facebook në vitin 2018, gjë që ka rezultuar me largimin e 652 llogarive dhe faqeve të rrejshme për shkak të “sjelljes së koordinuar joautentike”.

**Keqinformimi** është informatë e rrejshme, por e krijuar pa qëllim të shkakimit të dëmit.

#### **Shembull**

Pas sulmit me bomba në Mançester të Anglisë në vitin 2017, një gazetë lokale nxori gabimisht informata mbi një person të armatosur pranë një spitali lokal. Më vonë u vërtetua se kjo informatë ishte e gabueshme dhe gazeta e tërhoqi lajmin paraprak.<sup>6</sup>

Roli i qëllimit në shpërndarjen e informatave të rrejshme është kyç për të kuptuar dallimin mes keqinformimit dhe dezinformimit. Dezinformimi zakonisht është pjesë përbërëse e një përpjekjeje të qëllimshme për të mashtruar, ndikuar apo manipuluar ndërsa keqinformimi nuk ka për qëllim mashtrimin. Madje edhe me këtë dallim, qëllimet prapa krijimit dhe këmbimit të informatave jo gjithmonë janë të qarta.

**Informimi qëllimkeq** i referohet informatave faktike që shfrytëzohen me qëllim që një personi, organizate apo shteti t’i shkaktohet dëm.

#### **Shembull**

Gjatë procesit të zgjedhjeve paraprake presidenciale, emailat nga Komiteti Demokratik Kombëtar (DNC) janë shpërndarë në mënyrë selektive tek publiku për të dëshmuar anësinë e pretenduar të DNC-së gjatë fushatës.<sup>7</sup>

**Propaganda** i referohet fushatave për të shpërndarë informata që parashihet të manipulojnë audiencën duke gjeneruar qëndrime specifike apo provokuar veprime të caktuara.<sup>8</sup>

#### **Shembull**

Koreja e Veriut është e njohur për fushata promovimi të ndërmarrja me qëllim të indoktrinimit të popullatës së vet. Pothuajse të gjitha format mediatike, përfshirë muzikën, artin, filmin, kanë për temë krenarinë kombëtare. Qasja e kufizuar në internet dhe censurimi i mediave sociale i kontribuojnë këtyre veprimeve manipuluese nga qeveria e Koresë së Veriut.<sup>9</sup>

**Fushatat e informimit publik** i referohen aktiviteteve të organizuara të komunikimit që kanë për synim t’iu qasen grupeve më të mëdha të njerëzve dhe të formësojnë qëndrime publike, vlera apo besime të caktuara me shpresë të arritjes së një rezultati të caktuar social. Ky term duhet të dallohet nga propaganda, e cila nënkupton synimin për të manipuluar apo mashtruar.

#### **Shembull**

Në vitin 2016, ishulli grek Siros filloi një fushatë të informimit publik për ta njoftuar popullatën për efektet e dëmshme të ndotjes. Hulumtimi zbuloi se kjo fushatë ndryshoi me sukses qëndrimet e publikut ndaj ndotjes, që rezultoi me zvogëlim të niveleve të mbeturinave plastike në mjedisin detar.<sup>10</sup>

## Llojet më të shpeshta të keqinformimit dhe dezinformimit

Ekzistojnë shumë forma të keqinformimit dhe dezinformimit. Claire Wardle nga [First Draft News](#) i ka dalluar llojet e keqinformimit dhe dezinformimit në shtatë kategori të ndryshme, për të sqaruar



spektrin e përmbajtjes problematike që gjendet online dhe në media.

## Keqinformimi

| Type                    | Description   | Shembull  |
|-------------------------|---|---|
| Satira                  | Nuk ka për qëllim shkaktimin e dëmit, por ka potencial për të mashtruar                 | Një emision humoristik në televizion ose një koment social                                  |
| Lidhja e gabuar         | Kur titujt, paraqitjet vizuale apo titrat nuk e përkrasin përmbajtjen                   | “Karrem klikimi” një artikull i lajmeve online me tituj kontrovers ose shokues              |
| Përmbajtja keqduhëzuese | Shfrytëzim keqduhëzues i informatave për të krijuar imazhin mbi një çështje apo individ | Një foto që bën audiencën të besojë se një person gjendej në një lokacion ku ai nuk ka qenë |

## Dezinformimi

| Type                   | Description  | Shembull  |
|------------------------|--|---|
| Konteksti i rrejshëm   | Kur përmbajta e saktë shpërndahet me informata të gabueshme kontekstuale         | Informatat faktike dhe fotot origjinale çiftëzohen gabimisht  |
| Përmbajta e vjedhur    | Imitim i burimeve origjinale   | Informatat e rrejshme të cilat josaktësisht i atribuohen një burimi të madh apo kredibil të lajmeve |
| Përmbajta e fabrikuar  | Përmbajtje që është 100% e rrejshme dhe që ka për qëllim mashtrimin apo dëmtimin | Fotografitë e ndryshuara kompjuterikisht dhe të paraqitura si fakte                                 |
| Përmbajta e manipuluar | Kur informatat apo imazhet e vërteta manipulohen me qëllim të mashtrimit         | Fotografitë çiftëzohen me tekst të fabrikuar  |

## Kryerësit e veprave të tilla dhe motivet e tyre

Qëllimi është tipari kryesor dallues mes asaj që përbën keqinformim dhe dezinformim. Motivët që shtyjnë akterë të ndryshëm të krijojnë, prodhojnë dhe shpërndajnë dezinformata ofrojnë më shumë informata mbi fenomenin dhe mund të ndahen në katër kategori: financiare, politike, sociale dhe psikologjike. Edhe akterët shtetërorë edhe ata joshetërorë mund të shfrytëzojnë dezinformimin si mjet të manipulimit të opinionëve apo qëndrimeve. Politikanët mund të nxisin dezinformata mbi institucionet apo kundërshtarët politikë, vendorë apo të huaj, me qëllim të shtypjes së zërave të tyre dhe manipulimit të diskursit.<sup>11</sup> TKëta akterë politikë mund të jenë të lidhur me qeveri apo mund të jenë akterë privatë të cilët koordinohen me të tjerët për të vepruar në përkrahje të besimeve ideologjike të përbashkëta të tyre.

Akterë tjerë që shpërndajnë dezinformata mund të nxiten nga motive apolitike, siç janë zbavitja apo rritja e fitimit. Reklamimi në internet tani ofron një stimul financiar për të krijuar dezinformata të cilat mund të ndahen me shpejtësi dhe të joshin trafik online drejt një web-faqeje të caktuar. Manipulimi i mekanizmave të brendshëm të rrjeteve sociale për të ofruar përmbajtje (algoritme) dhe informata

të cilat kërkojnë vëmendje, mund të shtyhen nga akterë korporativë apo të pavarur të cilët mund të kërkojnë fitime më të mëdha nga trafiku online. Konsumatorët online mund të jenë në ndjekje të fitimit, pasi që argëtimi dhe lajmet ekzistojnë njëra pranë tjetrës në faqe të mediave sociale.<sup>12</sup> Akterë tjerë të pavarur mund të jenë të shtyrë nga motive të ndryshme, si një mundësi për të promovuar çështje personale, famë, apo edhe vetëm për të nevrkosur njerëzit apo për të vepruar si troll.

## Shpërndarja e informatave

Rritja e theksuar në botën e mediave sociale e ka shtuar numrin e mënyrave se si mund të shpërndahen dezinformatat. Platformat e mediave sociale janë shndërruar në vegla primare për fushata dezinformimi, si rrjedhojë e popullaritetit të tyre anembanë globit dhe lehtësisë së ndarjes së informatave me grupe private apo rrjete personale.<sup>13</sup> Përderisa mediat sociale kanë qëllime legjitime të ekzistimit, ato mund të shfrytëzohen edhe për qëllime të këqija.

Platformat e mediave sociale përmes së cilave kryhet dezinformim dhe keqinformim:

- Facebook
- Twitter
- YouTube
- Blogs
- Tabela mesazhesh

Përveç listës së mësipërme, aplikacionet mobile të dërgimit të mesazheve janë bërë një mjet i popullarizuar i dezinformimit. Këto aplikacione dallojnë nga platformat tjera të mediave sociale ngase janë të dizajnuara për të realizuar biseda private mes akterëve e jo për të vepruar si forume publike për më shumë akterë.<sup>14</sup> Aplikacionet si WhatsApp, Viber, Telegram, dhe WeChat janë të pajisura me kodim nga njëri përdorues tek tjetri, i cili parandalon ekzaminimin e përmbajtjes së mesazhit, përfshirë kompaninë.

Edhe pse mediat sociale janë mjet primar i dezinformatave, edhe mjetet më konvencionale mediatike gjithashtu janë shfrytëzuar në të kaluarën për të shpërndarë dezinformata, përfshirë:

- Gazetat
- Televizionin
- Webfaqet e lajmeve
- Radiot

Marrëdhënia mes burimeve mediatike tradicionale dhe mediave sociale në peizazhin informativ zbulon një dinamikë komplekse. Mediat sociale mund të shfrytëzohen për të shpërfytyruar apo amplifikuar storie që rrugëtojnë në forma të ndryshme, ndërsa mediat tradicionale të lajmeve dhe burimet e tilla shpesh raportojnë mbi trendet e mediave sociale. Kjo krijon një rikthim negativ të dezinformatave që zmadhon informatat e pasakta. Shpesh një kontrollim i thjeshtë i informatave dhe fakteve online rezulton me pasojën e padëshiruar të amplifikimit të mëtejshëm të informatave të pasakta.

## Instrumentet e shpeshta të dezinformimit

Shpërndarësit e dezinformatave janë bazuar në disa taktika të ndryshme të shpërndarjes së dezinformatave, veçanërisht përmes mjeteve digjitale. Shumë prej këtyre strategjive konsiderohen **propagandë kompjuterike**, që Instituti i Internetit në Oksford e definon si “shfrytëzim i algoritmeve, automatizimit dhe ndikimit njerëzor për të shpërndarë qëllimisht informata keqduhëzuese përmes rrjeteve të mediave sociale.”<sup>15</sup> Propaganda kompjuterike është metodë përmes së cilës mund të shpërndahet përmbajtja dezinformuese. Disa shembuj të këtyre taktikave përfshijnë:

- **Personalitetet e rrejshme dhe trollët:** akterët që përpiqen të shpërndajnë dezinformata mund të krijojnë profile të rrejshme të mediave sociale, nën emra të rrejshëm, për të shërbyer si mbulesë dhe për të mbrojtur kredibilitetin e informatave të ndara. Ngjashëm me botët, trollët mund të amplifikojnë dezinformimin, megjithatë, trollët kanë për cak akterë specifikë dhe feramat e trollëve punojnë në mënyrë efikase për të heshtur opozitën gjatë fushatave të dezinformimit.
- **Manipulimin me algoritme:** strategji e manipulimit të trendeve të rrjeteve të mediave sociale për të shpërndarë më shumë dezinformata. Manipulimi i algoritmit mund të shfrytëzohet ose për të shpërndarë dezinformata ose për të luftuar shpërndarjen e tyre, por manipulimi i trendeve për të luftuar dezinformimin përbën strategji më agresive.
- **Botët e mediave sociale:** llogari të automatizuara të cilat janë të krijuara për të shpërndarë me shpejtësi dezinformata ose komunikuar me njerëz. Përderisa shumë botë shfrytëzohen për të shpërndarë me shpejtësi informata të llojeve të ndryshme, të njëjtat janë manipuluar nga akterë të ndryshëm edhe për t'i manipuluar algoritmet e mediave sociale dhe për t'i ndryshuar informatat të cilat i shohin konsumuesit e tyre. Rrjeti i botëve mund të shfrytëzohet për të tërhequr vëmendjen ndaj temave të ndryshme dhe për të krijuar iluzionin e diskutimit publik dhe përkrahjes së publikut për atë çështje.
- **Imazhet vizuale:** janë manipulime të fotografive ose video incizimeve që shfrytëzohen për ta bërë audiencën që të besojë një gjë të caktuar. Një trend i ri, i cili njihet si 'deepfake', ngërthen krijimin e video incizimeve të rrejshme duke shfrytëzuar imazhe të njerëzve të vërtetë, të cilat kompiohen nga burime të ndryshme audiovizive e të cilat janë të dizajnuara për t'i mashtruar edhe audiencën edhe ekspertët.<sup>16</sup>
- **'Meme', apo përmbajtjet kulturore:** dizajnohen për t'u shpërndarë dhe për tu bërë 'virale', dhe mund të jenë në formë teksti, imazhi apo videoje.
- **'Doxing':** lloj i informimit qëllimkeq, ku dikush hulumton, siguron jashtëligjshëm dhe publikon në internet informatave private mbi një individ apo organizatë, me qëllim të dëmtimit të tij. Informata të tilla janë emrat, adresat, numrat e telefonit apo detajet e kreditkartelave, të cilat mund të shfrytëzohen për të shantazhuar, zhvatur apo ngacmuar cakun e kësaj forme veprimi.

## Kundërmasat për luftimin e dezinformimit

Shoqëria civile, kompanitë teknologjike, partitë politike, qeveritë dhe qytetarët kanë ndërmarrë masa të ndryshme për të luftuar dezinformimin. Siguria digjitale është kritike për parandalimin e manipulimit të informatave apo ndarjen e informatave me akterë të cilët do t'i shfrytëzojnë ato informata për të dëmtuar dikë, dhe përfshin forcimin e fjalëkalimeve, shfrytëzimin e rrjeteve virtuale private (VPN) dhe mundësimin e autentifikimit me dy faktorë.

Kompanitë teknologjike kanë filluar të ndërmarrin masat në vijim për ta luftuar dezinformimin:

- **Zbulimi i botëve të automatizuar:** Edhe pse jo të gjithë botët janë krijuar për qëllime të këqija, është e rëndësishme kyçe që të identifikohen botët të cilët shpërndajnë dezinformata dhe të merre masa për të ndalë veprimtarinë e tyre.<sup>17</sup> Zbulimi i llogarive të automatizuara mund të ndihmojë në luftimin e shpërndarjes së dezinformatave, në veçanti përmes platformave të mediave sociale, si Facebook dhe Twitter.
- **Analiza e rrjetit:** Zbulimi i mënyrës së veprimit të llogarive të automatizuara nënkupton të kuptuarit e mënyrës së veprimit të fushatave dezinformuese dhe si akterët koordinohen me njëri-tjetrin për të shtrirë edhe më tej qasjen e dezinformatave të caktuara.

**Kontrollimi i fakteve** të mediave tradicionale dhe informatave që shpërndahen online përbën një tjetër kundërmarrëse potenciale ndaj dezinformimit. Kontrollimi i fakteve duhet të jetë pjesë e një qasjeje shumështrësore të ndërmarrë nga më shumë akterë, siç janë organizatat e shoqërisë civile, partitë

politike, ministrinë e arsimit, ligjvënësit dhe kompanitë teknologjike. Vërtetimi i saktësisë së qëllimit të informatave mund të jetë punë sfiduese, pasi që kontrolluesit e fakteve nuk mund të përgjigjen aq shpejt sa që mund të shpërndahen informatat. Kontrollimi i fakteve të mediave tradicionale duhet të përcillet si formë edhe në mediat sociale për t'u siguruar që ato nuk rivëjnë në qarkullim informata të rrejshme.

### **Shembull**

Një kompani në Tajvan ka krijuar një vegël të kontrollimit të fakteve brenda platformës së dërgimit të mesazheve LINE, të quajtur [CoFacts](#). Kjo vegël përpilon një bazë të të dhënave të mesazheve më të popullarizuara të dezinformimit dhe bazohet në veprime kolaborative mes kontrolluesve të fakteve dhe përdoruesve.<sup>18</sup>

### **Shembull**

Veglat e kontrollimit të fakteve, siç janë [Chequeabot](#) në Argjentinë dhe [Full Fact](#) në Britani të Madhe, janë përpjekur ta luftojnë problemin e rivënies në qarkullim të informatave të rrejshme duke kontrolluar automatikisht pretendimet e bëra në media kundrejt statistikave zyrtare dhe informatave të verifikuara.<sup>19</sup>

Një tjetër komponent i rëndësishëm i luftimit të dezinformimit është **rikthimi i besimit të qytetarëve në institucionet politike**, përfshirë mediat. Kritika e mungesës së besimit në aftësinë e institucioneve për të ofruar informata të sakta dhe të paanshme u ka ofruar mundësi dhe hapësirë akterëve të ndryshëm për të promovuar dezinformimin. Kjo më tej ndikon të besuarit e qytetarëve në informatat që i pranojnë. Ngritja e besimit tek institucionet bëhet përmes një dialogu të mirëfilltë mes akterëve, siç janë partitë politike dhe organizatat e të drejtave të qytetarëve, me qëllim që të kuptohet më mirë se si dezinformatat dëmtojnë demokracinë. Kjo përfshin krijimin e udhëzuesve të mirësjelljes gjatë fushatave online, në veçanti në rastet kur dezinformatat mund të luajnë rol të caktuar në formësimin e mënyrës së sjelljes gjatë fushatës. Gjatë periudhave zgjedhore, monitoruesit e zgjedhjeve do duhej të punonin në minimizimin e efekteve të dezinformatave në bazë të të kuptuarit të tyre mbi kontekstin lokal dhe mjedisin mediatik në të cilin qytetarët i konsumojnë informatat. Monitoruesit e zgjedhjeve po ashtu mund të ndihmojnë në zbulimin e origjinës së përmbajtjes online dhe të monitorojnë mediat tradicionale si pjesë e përpjekjes së tyre për të luftuar pretendimet e rrejshme. Monitoruesve të zgjedhjeve mund t'u duhet asistencë shtesë për të identifikuar dhe kuptuar se kujt i dedikohen këto informata të rrejshme dhe cili është qëllimi i tyre.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) janë të përfshira në përpjekjet për të ngritur integritetin e informatave përmes fushatave edukuese dhe përfshirjen e tyre gjithmonë e më të theksuar në ngritjen e të nivelit të të kuptuarit të mediave nga qytetarët. Fushatat mbi të kuptuarit e mediave dhe informatave që ndërmerren për të avancuar nivelin e konsumimit të përmbajtjes mediatike, në veçanti në sferën digjitale, janë shndërruar në strategji të popullarizuara për luftimin e dezinformatave. Femrat, të rinjtë dhe të moshuarit përbëjnë grupet të cilat më shpesh trajtohen përmes fushatave të tilla, në veçanti në ato lidhur me mediat sociale, pasi që këto grupe demografike e kanë shtuar nivelin e angazhimit digjital dhe shfrytëzimit të shërbimeve platformave mediatike online.<sup>20</sup> Megjithatë, të rejtat janë dekurajohen joproporcionalisht nga dezinformatat dhe ka më shumë gjasa të përballen me barriera në të kuptuarit e mediave se sa të rinjtë, gjë që kufizon efektivisht pjesëmarrjen e tyre në botën online. Popullata e re, nëse ekspozohet ndaj dezinformatave të cilat krijojnë dhe fuqizojnë dyshime ekzistuese lidhur me besueshmërinë e institucioneve, mund të kërkojë burime alternative të informimit me çka edhe më tej dëmtohet aftësia e tyre për të vepruar si qytetarë të informuar. Popullata me nivel më të ulët të të kuptuarit të informatave, veçanërisht komunitetet që kanë më pak qasje në edukim formal, gjithashtu mund të gjenden në mesin e grupeve të cenuara. Fushatat specifike mbi të kuptuarit më të mirë të mediave dhe informatave kanë potencialin e ngritjes së nivelit të të kuptuarit të fushatave të dezinformimit, qofshin ato tradicionale apo online.

# Faktorët që ndikojnë në përhapjen e dezinformatave

Përgjithësisht, ekzistojnë dy lloj rrethanash në të cilat dezinformatat mund të lulëzojnë më shpejt. Rrethanat e para janë kohore dhe kemi të bëjmë me momente kur ngritet ndjeshmëria e informatave, do të thotë momente kur integriteti i informatave është jetik dhe sasia e informatave të ndara është më e lartë. Këto pika presioni përfshijnë zgjedhjet apo referendumet, gjatë të cilave merren vendime kyçe të qytetarëve mbi të ardhmen politike, siç ishte rasti i referendumi britanik për anëtarësi në Bashkim Evropian apo zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Rrethanat tjera kanë të bëjnë me faktorë më të gjerë strukturë dhe rrethanorë të cilët kanë ndikim në shumë shtresa të jetës shoqërore, ekonomike dhe politike. Për shembull, kontekstet e ndjeshme që ndikojnë në stabilitetin politik, siç janë luftërat apo konfliktet e zgjatura, mund të krijojnë stimuj për akterë që të ndotin hapësirën informative me dezinformata dhe të dëmtojnë edhe më tej besimin e qytetarëve në institucionet edhe ashtu të dobëta të tyre. Nivelet e larta të polarizimit gjithashtu mund të mundësojnë lulëzimin e dezinformatave duke dobësuar lidhjet sociale mes njerëzve dhe grupeve që kanë qëndrime të ndryshme ideologjike dhe politike.

## Shembuj të vendeve të ndryshme

Kërcënimet ndaj integritetit të informatave shpesh manifestohen ndryshe, varësisht nga konteksti. Shembujt në vijim ilustrojnë dezinformimin, keqinformimin apo informimin qëllimkeq dhe ndikimin e këtyre kërcënimeve në demokraci.

### Francë

Gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2017, fushata e kandidatit presidencial Emmanuel Macron pësoi një sulm kibernetik në sistemin e emailave. Hakerët nxorën një sasi të madhe të emailave që i përkisnin partisë së Macronit, En Marche!, pak para implementimit të heshtjes zgjedhore në media dhe fushatë me të cilën ndalohej diskutimi publik mbi çështjen.<sup>21</sup> Rrjedhja e informatave u përcoll me një sërë storiesh të rrejshme të cilat u shpërndanë nëpër media sociale e kishin të bënin me jetën personale të Macron dhe etikën profesionale të tij, e që për qëllim kishin diskreditimin e tij si kandidat. Fushata e Macron u përgjigj duke denoncuar sulmin nga hackerët dhe duke ngritur dyshime mbi natyrën e këtij sulmi, duke nënvizuar se disa dokumente ishin sajuar qëllimisht nga fushata për t'i mashtruar hackerët. Rrjedha e këtyre informatave kishte pak ndikim në rezultatin final të zgjedhjeve, pasi që mediat tradicionale nuk i kishin dhënë shumë hapësirë ndërsa kompanitë mediatike e krijuan një rrjet për të vërtetuar informatat me përkrahje të FirstDraft, ndërsa Macron fitoi zgjedhjet në fund.<sup>22</sup>

### Kenia

Pjesë të mëdha të popullatës së re, të cilët parimisht informatat i pranojnë përmes platformave të mediave sociale, mund të jenë më të cenueshëm dhe të bëhen pre e dezinformimit përmes këtyre forumeve online. Fushatat e dezinformimit në Kenia që kanë për qëllim thellimin e ndasive etnike dhe ngritjen e tensioneve ekonomike nuk janë risi, por mediat sociale kanë bërë që fushëveprimi dhe përmasat e këtyre fushatave të dezinformimit të jenë edhe më akute.<sup>23</sup> Gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2017, të rinjtë përbënin rreth gjysmën e elektoratit të regjistruar në Kenia. Shumë të rinj përcillnin zhvillimet politike në vend përmes mediave sociale, në veçanti përmes WhatsApp, Facebook, dhe Twitter. Këto platforma të mediave sociale zëvendësuan burimet tradicionale të informimit në vend – qeverinë, mediat e rëndomta dhe shoqërinë civile, duke i larguar kështu barrierat që parandalonin informimin e saktë dhe duke bërë që dezinformatat të shpërndahen lirshëm nëpër peizazhin mediatik. Disa prej dezinformatave që u shpërndanë përmes mediave sociale, përfshirë lajmet e rrejshme mbi

largimet e prurjet partiake, kishin për synim paraqitjen se vinin nga burime të besueshme të lajmeve, si CNN, BBC dhe NTV Kenya.<sup>24</sup> Këto storie shpesh ishin të dizajnuara për të diskredituar politikanë specifikë apo për të krijuar narrative të rrejshme mbi parti politike dhe veprime të caktuara. Kjo përbënte një përpjekje për të shkaktuar edhe më shumë ndasi ndaj elektoratit të ri dhe për të ndikuar votën e tyre në garën tejet të ngushtë dhe kontraverse politike mes Presidentit në detyrë Uhuru Kenyatta dhe udhëheqësit të opozitës Raila Odinga.

## Meksikë

Dezinformimi në Meksikë nuk është ndonjë fenomen i ri; ai është shfrytëzuar historikisht nga partitë në pushtet kundër partive në opozitë. Megjithatë, në kontekstet e fundit, dezinformimi është shfrytëzuar për të eksploatuar edhe më tej nivelin e ulët të besimit në institucione, përfshirë këtu qeverinë dhe mediat tradicionale, si mjet kundër demokracisë në Meksikë. Besimi i zbehtë ka shtuar cenueshmërinë nga dezinformimi, e platformat e mediave sociale, si Facebook dhe WhatsApp janë shndërruar në burim primar të lajmeve politike për qytetarët. Shumë fushata të dezinformimit janë zbuluar gjatë zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura në korrik të vitit 2018. Për shembull, një lajm i rrejshëm i shpërndarë 8,000 herë nga një faqe e Facebook e quajtur Amor a Mexico pretendonte që Andres Manuel Lopez Obrador, atëbotë pretendent në zgjedhjet presidenciale e sot President i vendit, ishte nipi i një nacisti.<sup>25</sup> Verificado, konsorcium i organizatave të shoqërisë civile dhe mediave, e themeluar nga Facebook Google, dhe AJ+ Español, përgënjeshtroi këtë storie dhe shumë tjera. Një nga organizatat partnere të NDI, Animal Politico, morri pjesë në këtë projekt bashkëpunues që grumbullonte organizata që bënin kontrollim të fakteve dhe gazetarë e ekspertë të mediave sociale dhe debateve politike.<sup>26</sup>

## Mianmar

Dezinformimi në Mianmar shpesh është shfrytëzuar për të ndikuar opinionin publik mbi gjendjen e marrëdhënieve sociale në vend, veçanërisht mbi statusin social të pakicave fetare dhe etnike. Diskriminimi i rrënjosur në vend mund të parandalojë pjesëmarrjen e komuniteteve të marginalizuara në jetën qytetare, ndërsa shtimi i qasjes në teknologji dhe shfrytëzimit të saj mund ta përkeqësojë edhe më tej këtë nivel diskriminimi. Para shtrirjes së gjerë të internetit në vend, grupet radikale brenda Mianmarit shpërndanin fletushka dhe video me informata të rrejshme lidhur me komunitetin mysliman, për të ngritur opinionin negativ publik mbi këtë grup. Qasja e ngritur në internet dhe rrjetet sociale intensifikoi shpërndarjen e dezinformatave në vend dhe Facebook u shndërrua në mjet kyç të qasjes në internet, duke bërë që disa përdorues të mos jenë fare të vetëdijshëm se interneti ekziston dhe funksionon edhe jashtë kësaj platforme. Si rezultat, për shumë njerëz Facebooku ishte sinonim për internetin. Në korrik të vitit 2014, stori e rrejshme në Facebook për një pronar mysliman të një shitoreje i cili pretendohet se kishte dhunuar një punonjëse budiste të tij rezultoi me dy ditë trazira në Mandalay dhe vdekjen e dy personave, por edhe me ngritje të tensioneve mes komunitetit mysliman dhe atij budist.<sup>27</sup> Më vonë, një gjykatë e vendit dënoi pesë persona për shpërndarje të pretendimeve të rrejshme që rezultuan me trazira, përfshirë një grua budiste e cila pranoi se është paguar për të bërë një ankesë të rrejshme në polici dhe pretenduar se ishte dhunuar.<sup>28</sup>

## Nigeri

Mungesa e informatave të sakta dhe transparencës ka rezultuar me një sërë fushatash dezinformimi në platformat e mediave sociale në Nigeri. Mediat sociale si Facebooku janë tejet të popullarizuara atje, ndërsa edhe qasja në teknologji të telefonave të mençur është trend në rritje. Këto fushata ishin dizajnuar për të ngritur tensionet mes komuniteteve të barinjve dhe fermerëve dhe rezultuan me qindra njerëz të vdekur. Më e theksuara ishte në qershor të vitit 2018, kur në platforma të mediave

sociale qarkulluan fotografi të rënda të cilat dukej se paraqisnin viktimat e fundit të dhunës në vend. Këto fotografi më vonë u dëshmuar se kishin qenë të rasteve që fare nuk kishin lidhje me këtë.<sup>29</sup> toriet e lajmeve në media sociale ia atribuonin dhunën përgjatë rrugës Labo-Ibadan barinjve dhe kishin për synim krijimin e kaosit dhe minimin e sigurisë në disa rajone të caktuara, duke bërë madje edhe fabrikim anonim të audios dhe alarmeve të sigurisë. Policia më vonë i kishte mohuar këto raportime të rrejshme, të cilat veçse ishin shpërndarë përmes mediave sociale.<sup>30</sup> Duke reaguar ndaj fushatave të dezinformimit në vend, Ministria e Informatave e Nigerisë lansoi një fushatë për promovimin e të kuptuarit të mediave, e cila do t'i edukojë nigerianët lidhur me efektet e dezinformimit mbi demokracinë në vend.<sup>31</sup>

## Serbi

Dezinformimi dhe manipulimi i informatave janë shndërruar në strategji të zakonshme në Ballkanin Perëndimor, duke pasur si synim marrëdhëniet e Ballkanit me Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Organizatën e Traktatit Vëri Atlantik (NATO). Fushata të orkestruara të dezinformimit janë ndërmarrë në Serbi viteve të fundit dhe të njëjtat kishin për qëllim manipulimin e opinionit publik kundër institucioneve evropiane të paqes dhe sigurisë dhe përkrahjen për ngritjen e tensioneve rajonale. Një raport i Qendrës për Hulumtime, Transparencë dhe Llogaridhënie (CRTA) nga Beogradi zbuloi se brenda një muaji pothuajse një e treta e raporteve mediatike mbi akterët e huaj në Serbi nuk citonte asnjë burim të jashtëm të lajmeve. Pjesa më e madhe e kësaj përmbajtjeje promovonte qëndrime proruse dhe kundër SHBA-ve.<sup>32</sup> Vazhdon të ekzistojë brenga se këto informata të dezinformimit mund të minojnë përpjekjet për anëtarësim në BE, veçanërisht nëse votuesit fillojnë të kthehen kundër Bashkimit Evropian dhe qeverisë së tyre.

Instituti Demokratik Kombëtar është duke ndërmarrë një sërë veprimesh për të mbrojtur integritetin e informatave në vendet demokratike, përfshirë:

- Kryerjen e hulumtimeve mbi cënueshmërinë dhe përballueshmërinë e dezinformimit nga vende të ndryshme.
- Integrimin e ekspertëve në misione të vëzhgimit të zgjedhjeve, për të vlerësuar ndikimin e informatave të komprometuara mbi zgjedhjet, dhe bashkëpunimin me partnerë monitorues të zgjedhjeve.
- Zhvillimin e veglave për të zbuluar, analizuar dhe luftuar kërcënimet për integritetin e informatave me partnerët dhe gjetjen e mënyrave për t'i shpërndarë tutje gjetjet e tyre.
- Përkrahjen e dialogut mes partive politike lidhur me integritetin e informatave dhe fuqizimin e masave të sigurisë kibernetike.
- Partneritetin me kompani të mediave sociale dhe organizata tjera demokratike për të mbrojtur integritetin e informatave dhe promovuar diskurs demokratik [Design for Democracy Coalition](#).
- Bashkëpunimit mes organizata qytetare si pjesë e [INFO/tegrity Initiative](#) për të ngritur transparencën e institucioneve dhe shtuar besimin e publikut në to.

## Siri

Trazirat civile në Siri u dhanë mundësinë akterëve vendorë dhe të huaj që të shfrytëzojnë dezinformimin si mjet për të ndikuar opinionin publik lidhur me luftën atje. Në vitin 2016, hakerët rusë kishin si cak Helmetat e Bardha të Mbrojtjes Civile Siriane, një organizatë jofitimprurëse që merrej me kërkim-shpëtim, duke e akuzuar atë për mbështetje të organizatave terroriste.<sup>33</sup> Edhe pse organizatat dhe gazetarët hulumtues që merren me kontrollim të fakteve e zbuluan se këto pretendime janë të

kishin qenë cak i sulmeve jo për shkak të punës së tyre në shpëtim jetësh por për shkak të të përpjekjeve të tyre për të dokumentuar atë që po ngjante në vendin e tyre. Dezinformuesit, në veçanti në kohë konfliktesh, përpiqen që të diskreditojnë organizatat jofitimprurëse dhe organizatat tjera të shoqërisë civile me qëllim të nxitjes së kaosit dhe konfuzionit.

## Ukrainë

Akterë online proruse kanë promovuar aktivisht dezinformimin në Ukrainë përmes shfrytëzimit të mediave sociale të sponsoruara nga shteti. Një nga qëllimet e kësaj strategjie ishte të krijohet dyshim lidhur me natyrën e informatave dhe stabilitetin e shtetit, duke e vërsuar sferën publike me përmbajtje të rrejshme.<sup>35</sup> Operacionet kundër qeverisë së Ukrainës dhe institucioneve mediatike kanë për qëllim edhe minimin e unitetit dhe stabilitetit në vend, duke e amplifikuar mosbesimin e qytetarëve në shtet. Gjatë një serie të protestave antiqeveritare në vitin 2014, në pjesën lindore të Ukrainës u shfrytëzuan narrative të ndryshme lidhur me natyrën e tyre, nën udhëheqjen e akterëve të jashtëm që shtreshin si qytetarë të Ukrainës. Fushatat e dezinformimit përmes mediave sociale dhe tradicionale sugjeronin se protestuesit në Kiev po mbështetnin përndjekjen e popullatës etnike ruse në pjesën lindore të vendit. Kjo luftë informative u krye bashkërisht me sulme kibernetike mbi institucionet qeveritare dhe infrastrukturën kyçe në vend, që i kontribuoi rritjes së perceptimeve të qytetarëve se qeveria ishte e paaftë që të garantojë siguri për qytetarët e vet.<sup>36</sup>

## Mbretëri e Bashkuar

Referendumi në Mbretërinë e Bashkuar mbi anëtarësinë në Bashkimin Evropian (BE) zbuloi kërcënimin që dezinformimi përbën për parimet demokratike. Hulumtimet e Universitetit të Edinburgut zbuluan se mbi 400 llogari nga Rusia që kishin marrë pjesë në diskutime gjatë zgjedhjeve të vitit 2016 në SHBA ishin shfrytëzuar për të shpërndarë mendime lidhur me këtë votim. Llogaritë e trollëve u përpoqën të nxisin frikën nga myslimanët dhe imigrantët, me shpresë që do t'i shtyjnë britanikët që të votojnë në favor të largimit nga BE. Në shkurt të vitit 2018, Twitter konfirmoi gjatë një seance dëgjimore para Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit të SHBA-ve se trollë nga Rusia kishin pasur për synim votimin e largimit të Mbretërisë së Bashkuar nga BE. Pas ndërhyrjes së jashtme në votimet në fjalë, qeveria e MB krijoi Njësinë Kombëtare të Sigurisë së Komunikimit, e cila ka për mandat luftimin e dezinformimit nga akterë të huajë dhe vendorë.<sup>37</sup>



## Mirënjohjet

Ky punim është punuar nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) dhe është mundësuar falë financimit nga National Endowment for Democracy (NED). Qëndrimet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED.

Instituti Demokratik Kombëtar është organizatë jofitimprurëse, apatiake joqeveritare që punon në përkrahjen dhe fuqizimin e institucioneve demokratike anembanë botës, përmes pjesëmarrjes së qytetarëve, transparencës dhe llogaridhënies së qeverive. Që nga themelimi në vitin 1983, NDI dhe partnerët lokalë të tij janë angazhuar në përkrahjen dhe fuqizimin e institucioneve dhe praktikave demokratike, duke fuqizuar partitë politike, organizatat qytetare dhe parlamentet, mbrojtur zgjedhjet dhe promovuar pjesëmarrjen e publikut dhe transparencën dhe llogaridhënien qeveritare. Qasja mutlinacionale e NDI përkrahë idenë që përderisa nuk ekziston një model i caktuar i demokracisë, disa parime thelbësore shfrytëzohen nga të gjitha demokracitë. Për më shumë informata lidhur me NDI, ju lutemi ta vizitoni adresën [www.ndi.org](http://www.ndi.org).

National Democratic Institute  
455 Massachusetts Ave, NW - 8th Floor  
Washington, DC 20001  
Telephone: 202-728-5500  
Fax: 202-728-5520  
[www.ndi.org](http://www.ndi.org)



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

## FUSNOTAT

- 1 Claire Wardle dhe Hossein Derakhshan, "Information Disorder: Towards an Interdisciplinary Framework for Research and Policymaking," e publikuar më 27 shtator 2017, <https://rm.coe.int/information-disorder-report-november-2017/1680764666>, fq. 11-12.
- 2 Natalie Jomini Stroud et al., "Making Sense of Information and Judging its Credibility," Understanding and Addressing the Disinformation Ecosystem, Annenberg School for Communication, publikuar në mars të vitit 2018, <https://firstdraftnews.org/wp-content/uploads/2018/03/The-Disinformation-Ecosystem-20180207-v2.pdf>
- 3 Dean Jackson, "Issue Brief: How Disinformation Impacts Politics and Publics," publikuar më 17 tetor 2017, <https://www.ned.org/issue-brief-distinguishing-disinformation-from-propaganda-misinformation-and-fake-news/>.
- 4 Grupi i Nivelit të Lartë i Komisionit për Lajme të Rrejshme dhe Dezinformim online, "A Multi-Dimensional Approach to Disinformation: Report of the Independent High-Level Group on Fake News and Online Disinformation," publikuar në vitin 2017, f. 12.
- 5 Christopher Porter, "FireEye exposed an Iranian disinformation campaign. Not from Silicon Valley but from N. Virginia.," publikuar më 27 gusht 2018. Washington Business Journal. <https://www.bizjournals.com/washington/news/2018/08/27/fireeye-exposed-an-iranian-social-media.html>.
- 6 Caroline Jack, Lexicon of Lies: Terms for Problematic Information, Data & Society Research Institute, publikuar më 9 gusht 2017, [https://datasociety.net/pubs/oh/DataAndSociety\\_LexiconofLies.pdf](https://datasociety.net/pubs/oh/DataAndSociety_LexiconofLies.pdf), f. 2.
- 7 Theodore Schleifer dhe Eugene Scott, "What was in the DNC email leak?" 25 korrik 2016. CNN Politics. <https://www.cnn.com/2016/07/24/politics/dnc-email-leak-wikileaks/index.html>.
- 8 Dean Jackson, "Issue Brief: Distinguishing Disinformation from Propaganda, Misinformation, and 'Fake News,'" publikuar më 17 tetor 2017, <https://www.ned.org/issue-brief-distinguishing-disinformation-from-propaganda-misinformation-and-fake-news/>.
- 9 "Propaganda nation: how North Korea spreads its message", publikuar më 20 dhjetor 2011. The Journal Ireland. <http://www.thejournal.ie/propaganda-nation-how-north-korea-spreads-its-message-309343-Dec2011/>.
- 10 Kostas Bithas, Dionysis Latinopoulos, Charalampos Mentis, "The impact of a public information campaign on preferences for marine environmental protection. The case of plastic waste". Marine Pollution Bulletin, Elsevier Journal, 2018.
- 11 Tim Hwang, Digital Disinformation: A Primer, The Atlantic Council, publikuar në shtator 2017, [http://www.atlanticcouncil.org/images/Digital\\_Disinformation\\_Primer\\_web\\_0925.pdf](http://www.atlanticcouncil.org/images/Digital_Disinformation_Primer_web_0925.pdf).
- 12 Caroline Jack, Lexicon of Lies, fq. 3-4.
- 13 Alice Marwick dhe Rebecca Lewis, Media Manipulation and Disinformation Online, Data & Society Research Institute, publikuar më 5 maj 2017, [https://datasociety.net/pubs/oh/DataAndSociety\\_MediaManipulationAndDisinformationOnline.pdf](https://datasociety.net/pubs/oh/DataAndSociety_MediaManipulationAndDisinformationOnline.pdf), p. 26.
- 14 Nic Dias, "The Era of WhatsApp Propaganda is Upon Us," Foreign Policy, publikuar më 17 gusht 2017, <https://foreignpolicy.com/2017/08/17/the-era-of-whatsapp-propaganda-is-upon-us/>.
- 15 Samuel C. Woodley dhe Philip N. Howard, "Computational Propaganda Worldwide: Executive Summary," Computational Propaganda Research Project, Universiteti i Oksfordit, publikuar më 11 korrik 2017, <http://blogs.oii.ox.ac.uk/politicalbots/wp-content/uploads/sites/89/2017/06/Casestudies-ExecutiveSummary.pdf>.
- 16 Derek B. Johnson dhe Susan Miller, "The Dangers of 'Deep Fakes,'" GCN, publikuar më 18 korrik 2018, <https://gcn.com/articles/2018/07/18/deep-fakes.aspx>.
- 17 Chris Doten, "In Fight Against Online Disinformation, A Variety of Tools Are Needed," NDI DemocracyWorks, publikuar më 22 qershor 2018, <https://www.demworks.org/fight-against-online-disinformation-variety-tools-are-needed>.

- 18 Wu Min Hsuan, "TICTeC 2018: CoFacts, the chatbot that combats misinformation," publikuar më 8 maj 2018, <https://youtu.be/4V2dpdmf8IQ>.
- 19 Daniel Funke, "Automated fact-checking has come a long way. But it still faces significant challenges," Poynter, publikuar më 4 prill 2018, <https://www.poynter.org/news/automated-fact-checking-has-come-long-way-it-still-faces-significant-challenges>.
- 20 *Mapping of Media Literacy Practices and Actions in EU-28*, European Audiovisual Observatory, fq. 29.
- 21 Amanda Erickson, "Macron's emails got hacked. Here's why French voters won't hear much about them before Sunday's election," Washington Post, publikuar më 6 maj 2017, [https://www.washingtonpost.com/news/worldviews/wp/2017/05/06/macrons-emails-got-hacked-heres-why-french-voters-wont-hear-much-about-them-before-sundays-election/?utm\\_term=.be98b12ccd14](https://www.washingtonpost.com/news/worldviews/wp/2017/05/06/macrons-emails-got-hacked-heres-why-french-voters-wont-hear-much-about-them-before-sundays-election/?utm_term=.be98b12ccd14).
- 22 Boris Toucas, "The Macron Leaks: The Defeat of Informational Warfare," Center for Strategic International Studies, publikuar më 30 maj 2017, <https://www.csis.org/analysis/macron-leaks-defeat-informational-warfare>.
- 23 Tara Susman-Peña dhe Bebe Santa-Wood, "Kenyans need more than fact-checking tips to resist misinformation," Columbia Journalism Review, publikuar më 25 tetor 2017, <https://www.cjr.org/innovations/kenya-election-fake-news.php>.
- 24 Nanjira Sambuli, "How Kenya became the latest victim of 'fake news,'" Aljazeera, publikuar më 17 gusht 2017, <https://www.aljazeera.com/indepth/opinion/2017/08/kenya-latest-victim-fake-news-170816121455181.html>.
- 25 Elizabeth Dwoskin, "Facebook's fight against fake news has gone global. In Mexico, just a handful of vetters are on the front lines," The Washington Post, publikuar më 22 qershor 2018, [https://www.washingtonpost.com/business/economy/in-mexico-facebook-faces-challenges-as-it-seeks-to-keep-democracy-honest/2018/06/22/098d5f3a-7624-11e8-b4b7-308400242c2e\\_story.html?utm\\_term=.0683a7a965df](https://www.washingtonpost.com/business/economy/in-mexico-facebook-faces-challenges-as-it-seeks-to-keep-democracy-honest/2018/06/22/098d5f3a-7624-11e8-b4b7-308400242c2e_story.html?utm_term=.0683a7a965df).
- 26 Daniel Funke, "Journalists and tech companies are teaming up to fight fake news about the Mexican election," Poynter, publikuar më 13 mars 2018, <https://www.poynter.org/news/journalists-and-tech-companies-are-teaming-fight-fake-news-about-mexican-election>.
- 27 Samantha Stanley, "Misinformation and Hate Speech in Myanmar," First Draft News, publikuar më 16 maj 2017, <https://firstdraftnews.org/misinformation-myanmar/>.
- 28 "Myanmar convicts five over fake rape claim that sparked riots," Reuters, publikuar më 20 mars 2015, <https://uk.reuters.com/article/uk-myanmar-conviction-idUKKBN0MG11820150320>.
- 29 "Fake news and Nigeria's herder crisis," BBC News, publikuar më 29 qershor 2018, <https://www.bbc.com/news/world-africa-44655148>.
- 30 Dimeji Kayode-Adedeji, "No herdsmen attack on Lagos-Ibadan expressway - Police," Premium Times, publikuar më 7 shkurt 2018, <https://www.premiumtimesng.com/news/more-news/257886-no-herdsmen-attack-lagos-ibadan-expressway-police.html>.
- 31 Evelyn Okakwu, "Nigerian govt launches campaign against 'fake news,'" Premium Times, publikuar më 11 qershor 2018, <https://www.premiumtimesng.com/news/more-news/275846-nigerian-govt-launches-campaign-against-fake-news.html>.
- 32 "Disinformation Analysis on the Western Balkans: Lack of Sources Indicates Potential Disinformation," EU vs. Disinfo, publikuar më 3 gusht 2018, <https://euvsdisinfo.eu/disinformation-analysis-on-the-western-balkans-lack-of-sources-indicates-potential-disinformation/>.
- 33 Olivia Solon, "How Syria's White Helmets became victims of an online propaganda machine," The Guardian, publikuar më 18 dhjetor 2017, <https://www.theguardian.com/world/2017/dec/18/syria-white-helmets-conspiracy-theories>.
- 34 "Killing the Truth: How Russia is fueling a disinformation campaign to cover up war crimes in Syria", The Syria Campaign <https://thesyriacampaign.org/wp-content/uploads/2017/12/KillingtheTruth.pdf>
- 35 Daniel Arnaudo, A New Wave of Censorship: Distributed Attacks on Expression and Press Freedom, Center for International Media Assistance, publikuar në maj 2018, <https://www.cima.ned>.

[org/wp-content/uploads/2018/05/CIMA\\_A-New-Wave-of-Censorship\\_web\\_150ppi.pdf](https://www.wired.co.uk/article/twitter-russia-brexit-fake-news-facebook-russia).

- 36 Julia Summers, "Countering Disinformation: Russia's Infowar in Ukraine," University of Washington, publikuar më 25 tetor 2017, <https://jsis.washington.edu/news/russia-disinformation-ukraine/>.
- 37 Matt Burgess, "Twitter has admitted Russian trolls targeted the Brexit vote (a little bit)", Wired UK, publikuar më 8 shkurt 2018. <https://www.wired.co.uk/article/twitter-russia-brexit-fake-news-facebook-russia>.

